



GJYKATA SUPREME E KOSOVES

VRHOVNOG SUDA KOSOVA

DHOMA E POSAÇME

SPECIJALNA KOMORA

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
VI	
Nr.	2806 / 2026 - IN
Br.	
No.	
Nr i Fa.	
Br. Str	5
No. Pg.	
Data	25.06.2026
Datum	
Date	
Prishtinë / Pristina	

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës:	C-IV.-24-0202	Data:	19.06.2026
Titulli i dokumentit		Data e dokumentit	
AKTVENDIM		18.06.2026	

Pala	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT Rr. Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte, Prishtinë.
Pranuar nga:	
Titulli:	
Data e pranimit:	
Nënshkrimi	

G.P.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:372142

Datë: 18.06.2026

Numri i dokumentit: 09063742

C-IV-24-0202

Parashtruesi i kërkesës

Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit i PEJ003 NSH “KB Beci”
(Në likuidim) FI-8167/92 , Lagja Lakërishtë rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Kërkesa: Aplikimi për të marr leje nga Dhoma e Posaçme për të hequr dorë nga aseti P-70705005-00775-8 ZK Becë-Gjakovë, parcelë e regjistruar në emrin e PEJ003, NSH “KB Beci”

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren kryesuese Ganimete Puka, si dhe gjyqtarët anëtare të kolegjit Diellza Hoxha dhe Hasim Sogojeva, në seancën vendimmarrëse, me 16.06.2026, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. APROVOHET kërkesa Autoritetit të Likuidimit PEJ003 NSH “KB Beci” (në likuidim) dhe i LEJOHET heqja dorë nga aseti P-70705005-00775-8, me sipërfaqe prej 542 m2 ZK Bec Gjakovë, parcelë e regjistruar në emrin e NSH “KB Beci “ PEJ003.

2. Nuk caktohen taksa gjyqësore .

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 31.04.2024, parashtruesi Autoriteti i Likuidimit – Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka parashtruar kërkesë me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim me të cilin do t'i lejohej heqja dorë nga aseti që është pronë e NSH “KB Beci”, me nr PEJ003. Kërkesa mbështetet në faktin se sipas shtojcës së ligjit 04-L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit me leje të gjykatës mund të heq dorë nga një aset për rastet si në vijim:



Numri i lëndës: 2024:372142
Datë: 18.06.2026
Numri i dokumentit: 09063742

1. Neni 18 par 3.1 i Shtojcës së Ligjit të lartpërmendur parasheh rastet kur aseti është problematik apo jo profitabil dhe i cili sipas mendimit të arsyeshëm të AL-së, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe
2. Neni 18 par 3.2 i po të njëjtit ligj për AKP-në përcakton se mund të hiqet dorë nga çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të AL-së nuk mund të ushtrohet kontrollë efektive nga ana e ndërmarrjes, AL-së apo gjykatës. Duke pas parasysh mendimin e arsyeshëm AL-ja konsideron se aseti është jo profitabil dhe nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe për këtë arsye AL-ja aplikoj te Dhoma e Posaçëm që të jep lejen për të heq dorë nga aseti.

Për më tepër edhe neni 3 paragrafi 10, pika 4 i Rregullores nr. 8/2023 për Politika dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, parashihet që *‘Duke iu nënshtruar aprovimit të DHPC JS -së të kërkesës të cilën AL-ja ia parashtron asaj, AL-ja mv. d të heqë dorë prej një asemi ose disa asetëve të NSH-së në rrethana të caktuara sipas nenit 18.3.1 dhe 18.3.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Po ashtu në këtë nen përcaktohet edhe që të gjitha kërkesat për heqje dorë të asetëve paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve para se të dorëzohen në Dhomën e Posaçme sipas ligjit.*

Po ashtu incimi i procedurës për dorë nga ky aset bëhet edhe në bazë të nenit 4 par.1 i Rregullores nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të asetëve. Duke qenë se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë, atëherë komfor neni 7 par.1 të kësaj rregullore është kërkuar konfirmimi nga ana e autoriteteve lokale për të japur komentet e tyre në lidhje me destinimin apo shfrytëzimin e kësaj parcele.

Sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, aseti është joprofitabil dhe nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës dhe për këtë arsye, ashtu si është sqaruar më detajisht në arsyetimin më poshtë, AL aplikon te kjo gjykatë ti jap lejen për të hequr dorë nga aseti.

Parashtruesi tutje ka shtuar se duke pas parasysh që parcela nr. P-70705005-00775-8, ZK Bec Gjakovë, me sipërfaqe prej 542 m², shfrytëzohet si rrugë, siç mund të vërehet në bazë të raportit të gjendjes në terren. Autoriteti i Likuidimit erdhi në përfundim që aseti nuk është jo-profitabil dhe nuk është në gjendje të realizimit fitimprurës dhe tani më ka marrë edhe miratimin nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë për të hequr dorë nga aseti .Përveç kësaj, në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët “Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike”.

Autoriteti i Likuidimit komfor neni 7 par.1 të Rregullores nr. 04/2023, i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Gjakovës më datë 21 nëntor 2024 kërkesë që të konfirmojë që parcela shfrytëzohet si rrugë dhe përmes së cilës AL ka kërkuar nga organet kompetente komunale që të japin përgjigjen brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh, mirëpo nuk kanë pranuar ende ndonjë përgjigje.

Tutje ka shtuar se duke u bazuar në nenin 7 par.5 të Rregullores nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Asetëve, i cili përcakton që *‘ Në qoftë se një konfirmim i tillë nuk dërgohet nga ana e Autoritetit Komunal kompetent brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh, atëherë kjo nuk e pengon Autoritetin e Likuidimit që të paraqes raportin për heqje dorë në Bordin e Drejtorëve dhe po ashtu nuk e pengon as Bordin e Drejtorëve që të shqyrtojë kërkesën për heqje dore’* pasi që nuk kanë pranuar konfirmimin e kërkuar nga ana e Autoritetit kompetent ky



Numri i lëndës: 2024:372142
Datë: 18.06.2026
Numri i dokumentit: 09063742

raport paraqitet në Bordin e Drejtorëve për shqyrtim dhe vendosje. Në rast se një përgjigje do të pranohet në ndërkohë nga ana e autoriteteve lokale, atëherë e njëjta do të bashkëngjitet raportit për heqje dorë në DHPGJK apo e njëjta do të dorëzohet më vonë si dëshmi.

Pas aprovimit të kësaj kërkesë të AL-së nga ana e DHPGJSK, atëherë në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, i cili specifikon që 'në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent'

Andaj duke u bazuar në faktet dhe arsyet të paraqitura si më lartë, Autoriteti i Likuidimit i kërkon Dhomës së Posaçme të marrë leje për të hequr dorë nga aseti nr. parcela nr. P-70705005-00775-8 me sipërfaqe totale prej 542 m², ZK Bec-Gjakovë, siç përshkruhet në certifikatën nr. AKPPEJE13 të datës 04.11.2024.

Arsyetimi ligjor

Aprovohet kërkesa e AL-së dhe i lejohet të njëjtës të heqë dorë nga aseti nr. parcela nr. P-70705005-00775-8 me sipërfaqe totale prej 542 m², ZK Bec-Gjakovë, siç përshkruhet në certifikatën nr. AKPPEJE13 të datës 04.11.2024.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Autoriteti i Likuidimit pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lejimin e heqjes dorë nga aseti i NSH "KB Beci", përkatësisht parcela nr. P-70705005-00775-8, ZK Bec-Gjakovë, me sipërfaqe prej 542 m², që evidentohet në emrin të PSH "KB Bec, Gjakovë"

Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar në dispozitat e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, konkretisht në nenin 18 paragrafi 3.1 dhe 3.2, sipas të cilave Autoriteti i Likuidimit, me miratimin paraprak të gjykatës, mund të heqë dorë nga një aset kur ai është problematik, joprofitabil dhe nuk mund të realizojë përfitim ekonomik, apo kur mbi të nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ndërmarrja, Autoriteti i Likuidimit ose gjykata.

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se parcela në fjalë shfrytëzohet si rrugë publike dhe nuk paraqet aset që mund të administrohet, shfrytëzohet ose tjetërsohet në mënyrë fitimprurëse nga Autoriteti i Likuidimit. Për më tepër, duke qenë se parcela shërben për qarkullim publik, ajo nuk gjeneron të ardhura dhe nuk paraqet interes ekonomik për masën e likuidimit. Në këto rrethana plotësohen kushtet e nenit 18 paragrafi 3.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, pasi aseti është joprofitabil dhe nuk është në gjendje të realizojë përfitim ekonomik.

Po ashtu, gjykata vëren se për shkak të destinimit faktik të parcelës si rrugë, Autoriteti i Likuidimit nuk mund të ushtrojë kontroll efektiv mbi të, ndërsa as ndërmarrja shoqërore në likuidim nuk mund ta administrojë ose shfrytëzojë atë në funksion të procesit të likuidimit. Kjo situatë përmbush edhe kushtin e përcaktuar në nenin 18 paragrafi 3.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Gjykata merr parasysh gjithashtu se procedura e heqjes dorë është zhvilluar në pajtim me Rregulloren nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Rregulloren nr. 04/2023 për Politikën dhe Procedurat Ligjore të Heqjes Dorë të Aseteve. Nga provat rezulton se Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar nga Komuna e Gjakovës konfirmimin lidhur

me shfrytëzimin e parcelës si rrugë, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjor prej dhjetë (10) ditësh. Në përputhje me nenin 7 paragrafi 5 të Rregullores nr. 04/2023, mungesa e një përgjigjeje të tillë nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurës së heqjes dorë dhe as për shqyrtimin e kërkesës nga organet kompetente.

Gjykata vlerëson edhe faktin se Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka miratuar paraprakisht propozimin për heqje dorë nga ky aset, duke përmbushur kushtin procedural të kërkuar nga neni 3 paragrafi 10 pika 4 e Rregullores nr. 08/2023.

Më tej, sipas nenit 11 të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët, nuk lejohet bartja e pronësisë së një rruge publike ose të një pjese të saj tek persona fizikë apo juridikë, çka e bën të pamundur realizimin e këtij asemi përmes procedurave të zakonshme të likuidimit. Kjo rrethanë mbështet përfundimin se mbajtja e këtij asemi në masën e likuidimit nuk i shërben qëllimit të procedurës së likuidimit.

Në fund, gjykata konsideron se pas lejimit të heqjes dorë nga prona në fjalë, zbatohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, sipas të cilit në rast të heqjes dorë nga pronësia mbi një paluajtshmëri, pronësinë e fiton subjekti publik kompetent.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 18 paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenin 3 paragrafi 10 pika 4 të Rregullores nr. 08/2023, nenin 7 të Rregullores nr. 04/2023, nenin 11 të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugët, si dhe nenin 42 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore, gjykata gjen se janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e heqjes dorë nga aset i parcela nr. P-70705005-00775-8, ZK Bec-Gjakovë, me sipërfaqe 542 m².

Shpenzimet Gjyqësore: Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka - Gjyqtare kryesuese

Diellza Hoxha - Gjyqtare

Hasim Sogojeva - Gjyqtar

